

Në bazë të nenit 56 paragrafi 1 pika 2 të Ligjit të Sigurimit Shëndetësor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 25/00, 96/00, 50/01, 11/02, 31/03, 84/05, 37 / 06, 18/07, 36/07, 82/08, 98/08, 6/09, 67/09, 50/10, 156/10, 53/11, 26/12, 16/13, 91/13, 187/13, 43/14, 44/14, 97/14, 112/14, 113/14, 188/14, 20/15, 61/15, 98/15, 129/15, 150/15, 154/15, 192/15, 217/15, 27/16, 37/16, 120/16, 142/16 dhe 171/17), Këshilli Drejtues i Fondit të Sigurimit Shëndetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 28 tetor 2019, përcaktoi tekst përfundimtar të Statutit të Fondit të Sigurimit Shëndetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Teksti përfundimtar i Statutit të Fondit të Sigurimit Shëndetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut përfshin: Statutin e Fondit të Sigurimit Shëndetësor të Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/12), Vendimin statutor për ndryshimin e Statutit të Fondit të Sigurimit Shëndetësor të Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 64/15) dhe Vendimin statutor për ndryshimin e Statutit të Fondit të Sigurimit Shëndetësor të Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 178/19).

STATUTI

I FONDIT TË SIGURIMIT SHËNDETËSOR TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Tekst përfundimtar

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë statut, në përputhje me Ligjin e Sigurimit Shëndetësor, rregullohen: veprimtaria, organizimi dhe mënyra e funksionimit të Fondit të Sigurimit Shëndetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme Fondi), organet drejtuese dhe fushëveprimi i tyre, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e organeve të Fondit; përfaqësimi i Fondit, procedura e zgjedhjes dhe e shkarkimit të drejtorit të Fondit, organizimi dhe kryerja e çështjeve profesionale, administrative dhe çështjeve tjera, publiku në funksionimin e Fondit dhe të organeve të tij, procedura e miratimit të akteve të Fondit dhe çështje të tjera të rëndësishme për funksionimin e Fondit.

Neni 2

Fondi i Sigurimit Shëndetësor i Republikës së Maqedonisë deklaron të drejtat dhe detyrimet nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor dhe kryen veprimtari të tjera, në përputhje me Ligjin e Sigurimit Shëndetësor (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulloret e tjera.

Fondi kryen veprimtari me interes publik dhe ka autorizime publike të përcaktuara me ligj.

Fondi ka statusin e personit juridik, me të drejta dhe detyrime të përcaktuara me ligj

dhe me këtë statut.

Fondi është i pavarur në punën e tij.

Realizimi i të ardhurave dhe i shpenzimeve të Fondit bëhet përmes një nën-llogarie në kuadër të llogarisë së vetme të thesarit.

II. EMËRTIMI DHE SELIA E FONDIT

Neni 4

Emërtimi i Fondit në gjuhën maqedonase është: Фонд за здравствено осигурување на Република Северна Македонија.

Shkurtesa e emrit të Fondit në gjuhën maqedonase është: ФЗОPCM.

Emërtimi i Fondit në gjuhën shqipe është: Fondi i Sigurimit Shëndetësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Shkurtesa e emrit të Fondit në gjuhën shqipe është: FSSHRMV.

Emërtimi i Fondit në gjuhën angleze është: Health Insurance Fund of Republic of North Macedonia.

Shkurtesa e emrit të Fondit në gjuhën angleze është: HIFRNM

Selia e Fondit është në Shkup, rruga "Maqedonia" nr. 5

Neni 5

Në punën e tij, Fondi përdor vulat në vijim:

1. Vula e përdorur në shërbimin qendror të Fondit ka pamje: rreth me diametër 40 mm. Në mes të vulës është stema e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në gjysmërrethin e sipërm në rrethin koncentrik është shkruar emri i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në rrethin e dytë dhe të tretë koncentrik është shkruar teksti "Фонд за здравствено осигурување на Република Северна Македонија" dhe në të katërtin është shkruar "Сконје". Në gjysmërrethin e poshtëm, i njëjti tekst është shkruar në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe në alfabetin e saj.

2. Vula e përdorur në shërbimet rajonale të Fondit ka pamje të rrethit me diametër 40 mm. Në mes të vulës është stema e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në rrethin e parë konceptual është shkruar emri i Republikës së Maqedonisë Veriore dhe vendi ku është selia e shërbimit rajonal, në rrethin e dytë koncentrik shkruan

"Фонд за здравствено осигурување на Република Северна Македонија" dhe në rrethin e tretë koncentrik shkruan "подрачна служба".

Në vulat e përdorura në shërbimet rajonale të Fondit në Veles, Gostivar, Dibër, Kërçovë, Krushevë, Kumanovë, Prilep, Shkup, Strugë dhe Tetovë, në gjysmërrethin e sipërm në rrethin e parë koncentrik është shkruar emri i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në pjesën e dytë dhe të tretë të rrethit koncentrik shkruan "Фонд за здравствено осигурување на Република Северна Македонија", ndërsa në rrethin e katërt

koncentrik është shkruar emri i shërbimit rajonal. Në gjysmërrethin e poshtëm, i njëjti tekst është shkruar në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe në alfabetin e saj.

Nëse në shërbimin qendror të Fondit dhe në shërbimet rajonale të Fondit shfrytëzohen më shumë vula, një vulë është pa numër, ndërsa të tjerat kanë numrin e tyre.

Vula e shërbimit qendror dhe e shërbimeve rajonale të Fondit ka formë të drejtkëndëshit në të cilën shkruhet teksti “Република Северна Македонија - Фонд за здравствено осигурување на Република Северна Македонија” dhe vendi ku gjendet Fondi, përkatësisht shërbimi rajonal, ndërsa më poshtë - njësia organizative, numri, shtojca dhe vlera.

Në vulën që përdoret në shërbimin qendror dhe në vulat që përdoren në shërbimet rajonale të Fondit në Veles, Gostivar, Dibër, Kërçovë, Krushevë, Kumanovë, Prilep, Shkup, Strugë dhe Tetovë, teksti i paragrafit 4 të këtij neni është shënuar në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe në alfabetin e saj.

Vula që përdoret në shërbimin qendror dhe vulat që përdoren në shërbimet rajonale të Fondit në Veles, Gostivar, Dibër, Kërçovë, Krushevë, Kumanovë, Prilep, Shkup, Strugë dhe Tetovë kanë dimensione 65x40mm, ndërsa vulat e shërbimeve rajonale të tjera kanë dimensione 60x30mm.

III. FUSHËVEPRIMI I PUNËS SË FONDIT

Neni 6

Fondi kryen këto punë:

1. Zbaton rregulloret dhe politikat e zhvillimit dhe të përparimit të kujdesit shëndetësor në lidhje me sigurimin e detyrueshëm shëndetësor;
2. Me aktet e përgjithshme rregullon çështjet për të cilat është autorizuar me Ligj;
3. Planifikon dhe mbledh mjete nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor;
4. Siguron realizimin e të drejtës së sigurimit të detyrueshëm shëndetësor të personave të siguruar, kujdeset për realizimin e të drejtave të tyre ligjore dhe u jep ndihmë profesionale gjatë realizimit të të drejtave dhe interesave të tyre.
5. Institucioneve shëndetësore që ofrojnë shërbime shëndetësore ua paguan shërbimet shëndetësore për të siguruarit;
6. Pagan kompensimet e rrogave dhe kompensime të tjera në para
7. Përcakton çmimet e referencës së shërbimeve shëndetësore, të barnave, të pajisjeve ortopedike dhe të pajisjeve të tjera që i kompenson Fondi, për të cilat jep pëlqim ministri i Shëndetësisë;
8. Me institucionet shëndetësore, personave të siguruar u siguron shërbime shëndetësore, sipas normave dhe standardeve, bazuar në doktrinën e miratuar mjekësore për mbrojtje shëndetësore efikase dhe racionale;

9. Zhvillon sistem informativ vetanak me të dhënat e nevojshme për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor;
10. Zbaton marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor;
11. Kryen mbikëqyrje dhe kontroll të shtrirjes dhe llojit të dakorduar të shërbimeve të siguruara shëndetësore të personave të siguruar në institucionet shëndetësore;
12. Merr masa për shfrytëzim efektiv dhe ekonomik të mjeteve të sigurimit të detyrueshëm shëndetësor;
13. Vendos për të drejtat e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor të shkallës së parë;
14. Ndjek dhe analizon lëvizjen dhe zhvillimin e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor dhe propozon masa për zhvillim dhe përparim;
15. Kontrollon realizimin e mbrojtjes shëndetësore dhe të së drejtës për kompensime në para të të siguruarve;
16. Kryen kontroll të pagesës së rregullt të të ardhurave të të siguruarve;
17. Merr masa dhe procedura për mbrojtjen e mjeteve dhe të pronës së Fondit;
18. Mban evidencë për personat e siguruar, për taksapaguesit për pagesë të të ardhurave për sigurim të detyrueshëm shëndetësor dhe për të drejtat dhe detyrimet nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor;
19. Lëshon ueb faqe dhe shpallje të tjera profesionale dhe informative dhe
20. Kryen edhe detyra të tjera lidhur me të drejtat dhe detyrimet nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor.

IV. ORGANET E MENAXHIMIT DHE TË ORGANIZIMIT TË FONDIT

Këshilli Drejtues

Neni 7

Me Fondin udhëheq Këshilli Drejtues.

Këshilli Drejtues përbëhet prej 7 anëtarëve të cilët i emëron dhe shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në periudhë prej katër vitesh edhe atë:

- Një përfaqësues të propozuar nga Ministria e Shëndetësisë
- Një përfaqësues të propozuar nga Ministria e Financave
- Një përfaqësues të propozuar nga Shoqata e Sindikatave të Maqedonisë me princip rotacion vjetor të përfaqësuesve të autorizuar të Shoqatës,
- Një përfaqësues të propozuar nga dhomat e tregtarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me princip rotacion vjetor të përfaqësuesve të autorizuar të dhomave,
- Një përfaqësues të propozuar nga Dhoma e Mjekëve të Republikës së

Maqedonisë së Veriut, Dhoma e Stomatologëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Dhoma e Farmacistëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut me princip rotacion vjetor të përfaqësuesve të autorizuar të dhomave,

- Një përfaqësues të propozuar nga shoqata e pensionistëve dhe
- Një përfaqësues të propozuar nga të sigyruarit, propozuar nga Shoqata e Konsumatorëve,

Këshilli Drejtues ka kryetar dhe zëvendëskryetar nga përfaqësuesit e emëruar nga Ministria e Shëndetësisë dhe nga Ministria e Financave të cilët pas një viti, në mënyrë alternative, ndërrohen gjatë mandatit.

Neni 8

Këshilli Drejtues kryen këto detyra:

1. Merr pjesë në përcaktimin e zhvillimit të sigurimit të detyrueshëm shëndetësor;
2. Miraton statutin e Fondit;
3. Miraton aktet e përgjithshme për të cilat është i autorizuar me ligj;
4. Miraton programin dhe planin e punës;
5. Miraton rregulloren e punës të Këshillit Drejtues të Fondit;
6. Miraton akte për organizimin dhe sistemimin e Fondit;
7. Përcakton buxhetin dhe faturën përfundimtare të Fondit;
8. Miraton raportin vjetor për punën e Fondit;
9. Kujdeset për realizimin e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor;
10. Ndjek realizimin e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe kontratave ndërkombëtare nga fusha e sigurimit shëndetësor;
11. Shqyrton pyetje, raporte, informacione dhe materiale nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor;
12. Shpall konkurs për emërimin e drejtorit të Fondit;
13. Themelon komisione dhe organe të tjera punuese;
14. Vendos për të drejtat e marrëdhënies së punës në shkallë të dytë;
15. Jep pëlqim për udhëtimet zyrtare jashtë vendit të të punësuarve, kur me vendim të drejtorit të Fondit, në udhëtim zyrtar udhëzohen më shume se tre persona;
16. Vendos edhe për çështje të tjera të përcaktuara me këtë statut.

Neni 9

Këshilli Drejtues, vendimet dhe aktet i miraton me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

Neni 10

Kryetari i Këshillit Drejtues, mbledh dhe udhëheq me mbledhjet e Këshillit Drejtues, nënshkruan vendimet dhe aktet e përgjithshme të cilat i miraton Këshilli Drejtues, miraton shfrytëzimin e pushimit vjetor dhe udhëtimet zyrtare jashtë vendit të drejtorit të Fondit, kryen edhe punë të tjera në përputhje me dispozitat e statutit dhe të rregullores së punës së Këshillit Drejtues.

Kur kryetari mungon, nuk është në gjendje ose për arsye të tjera nuk i kryen obligimet, punët nga paragrafi 1 i këtij neni i kryen zëvendëskryetari.

Neni 11

Mënyra e punës së Këshillit Drejtues më afër rregullohet me rregulloren e punës së Këshillit Drejtues.

Drejtori i Fondit

Neni 12

Drejtori është organi drejtues i Fondit dhe përbëhet prej dy personave që janë në mënyrë të barabartë përgjegjës për punën e Fondit dhe për detyrimet që ndërmerren në qarkullimin ligjor.

Drejtori prezanton dhe përfaqëson Fondin.

Mandati i drejtorit zgjat 4 (katër) vjet, me mundësi rizgjedhjeje edhe një herë.

Drejtori i Fondit:

1. Udhëheq me punën e Fondit;
2. Kujdeset dhe përgjigjet për zbatimin e vendimeve të Këshillit Drejtues, të rregulloreve dhe të akteve të përgjithshme të Fondit;
3. Miraton aktvendime për të drejtat sipas sigurimit shëndetësor të detyrueshëm në përputhje me Ligjin dhe me aktet e përgjithshme të Fondit;
4. Siguron ligjshmërinë në punën e Fondit dhe në këtë kuptim jep udhëzime pune në Fond;
5. Propozon akte të përgjithshme të Fondit që i miraton Këshilli Drejtues;
6. Miraton aktvendim në lidhje me punët në Fond;
7. Miraton aktvendime për rrogat e nëpunësve në Fond;
8. Kujdeset për shfrytëzimin e drejtë dhe ekonomik të mjeteve të Fondit;
9. Organizon punën e shërbimit profesional të Fondit;
10. Përcakton nënshkruesit në emër të Fondit;
11. Vendos për udhëtimet zyrtare brenda dhe jashtë vendit;
12. Formon komisione dhe trupa punues të tjerë;
13. Kryen punë të tjera të përcaktuara me ligj, me statutin dhe me aktet e përgjithshme të Fondit;

Neni 13

Në rast të mungesës së njërit prej dy personave që përbëjnë Drejtorin, autorizimet e tij mund të barten te personi nga radhët e drejtorëve të sektorëve.
Autorizimet barten me pëlqimin e dy personave nga të cilët përbëhet Drejtori.
Bartja nuk mund të zgjasë më shumë se tridhjetë ditë.

Neni 14

Për punën e tij, Drejtori i Fondit është përgjegjës para Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Emërimi dhe shkarkimi i Drejtorit

Neni 15

Drejtorin e Fondit e emëron Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut me anë të konkursit publik, me propozim të ministrit të Shëndetësisë.

Drejtor i Fondit emërohet një person fizik, nga vendi, që do të ofrojë program më cilësor të punës së Fondit dhe i cili i plotëson kushtet e mëposhtme:

- arsim të lartë në fushën e menaxhimit, shkencave ekonomike, financave, administratës së biznesit, menaxhimit të shëndetit publik, shkencave mjekësore ose shkencave juridike.
- së paku 6 vite përvojë pune nga fusha e financave, menaxhimit ose nga sistemi dhe organizimi i mbrojtjes shëndetësore dhe sigurimit shëndetësor dhe
- njohje e rregulloreve nga fusha e mbrojtjes shëndetësore dhe sigurimit shëndetësor.

Njëri nga personat që emërohet Drejtor, detyrimisht të ketë arsim të lartë nga fusha e menaxhimit, shkencave ekonomike, financave ose administratës publike.

Neni 16

Këshilli Drejtues, me vendim shpall konkurs për emërim të drejtorit të Fondit.

Këshilli Drejtues, me vendimin e paragrafit 1 të këtij neni, emëron edhe komision konkursi, i cili ka për detyrë ta zbatojë procedurën e shpalljes së konkursit, pranimin e aplikimeve në konkurs, si dhe përgatitjen dhe dorëzimin e listës së kandidatëve të paraqitur.

Komisioni i Konkursit përbëhet nga kryetari i komisionit dhe katër anëtarë të tjerë.

Kryetari dhe anëtarët e komisionit të konkursit emërohen nga anëtarët e Këshillit Drejtues.

Neni 17

Konkursi për emërimin e Drejtorit të Fondit shpallet më së paku në dy gazeta ditore, nga të cilat, në njërin nga gazetatat që botohen në gjuhën maqedonase dhe tjetra, në gazetatat që botohen në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

Kohëzgjatja e konkursit nuk mund të jetë më pak se 30 ditë nga dita e publikimit në

mediat publike nga paragrafi 1 i këtij neni.

Komisioni i Konkursit ka për obligim që në afat prej 15 ditësh nga dita e mbylljes së konkursit, ta përgatisë listën e kandidatëve të paraqitur dhe të njëjtën t'ia dorëzojë Këshillit Drejtues.

Nëse Komisioni i Konkursit nuk e dorëzon brenda këtij afati listën nga paragrafi 2 i këtij neni, atëherë Këshilli Drejtues do të formojë komision të ri konkursi.

Neni 18

Këshilli Drejtues, pas realizimit të konkursit për zgjedhje të drejtorit të Fondit, listën e kandidatëve të paraqitur dhe të gjithë dokumentacionin e konkursit ia dorëzon ministrit të Shëndetësisë.

Neni 19

Drejtori i Fondit emërohet dhe e merr detyrën pas sjelljes së vendimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për emërimin e tij sipas propozimit të ministrit të Shëndetësisë.

Neni 20

Nëse janë plotësuar kushtet për shkarkim të Drejtorit të Fondit sipas nenit 59 paragrafi 1 pika 3 deri 7 të Ligjit të Sigurimit Shëndetësor, atëherë ministri i Shëndetësisë mund që Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut t'i propozojë shkarkimin e tij edhe para afatit për të cilin ishte emëruar.

Nëse shkarkimi bëhet për arsyet e përmendura në nenin 59 paragrafin 1 pikat 3 deri 7 të Ligjit të Sigurimit Shëndetësor, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të ministrit të Shëndetësisë do t'i shkarkojë të dy personat e emëruar për drejtor.

Nëse drejtori, në përputhje me Ligjin e Sigurimit Shëndetësor, do të shkarkohet para afatit për të cilin është emëruar, atëherë Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të ministrit të Shëndetësisë do të emërojë ushtrues detyre të drejtorit deri në emërimin e drejtorit sipas konkursit të shpallur, por jo më gjatë se gjashtë muaj.

Drejtorët e sektorëve

Neni 21

Me sektorët në shërbimin qendror të Fondit do të udhëheqin drejtorët e sektorëve.

Drejtorët e sektorëve i sistemon Drejtori i Fondit nga radhët e nëpunësve, në përputhje me aktin për organizimin e shërbimit profesional.

Drejtor i sektorit në Fond mund të jetë ndonjë nëpunës i sistemuar me arsim të lartë profesional përkatës dhe me të paktën 5 vjet përvojë pune.

Kolegjiumi Profesional

Neni 22

Drejtori i Fondit formon kolegjiun profesional si trup profesional këshillëdhënës i

Drejtorit të Fondit.

Neni 23

Kolegjiumi profesional ka këto kompetenca:

- dhënie e ndihmës profesionale në përgatitjen e përgjigjeve ndaj kërkesave në lidhje me punën në Fond,
- marrje e qëndrimeve profesionale në lidhje me zbatimin e vetëm të rregulloreve nga Sigurimi shëndetësor i detyrueshëm,
- shqyrtimi i draft-teksteve të akteve të përgjithshme, udhëzimeve, njoftimeve, raporteve dhe mendimeve profesionale të tjera,
- përcaktimi i qëndrimit të Fondit në lidhje me çështje të caktuara nga rendi ditor i Këshillit Drejtues të Fondit,
- shqyrtimi i mendimeve profesionale dhe i materialeve të punës para se të dorëzohen në seancën e Këshillit Drejtues të Fondit,
- çështje të tjera të përcaktuara me Ligj, me statut dhe me akte të përgjithshme të Fondit.

Neni 24

Kolegjiumi Profesional punon në seanca të cilat sipas nevojës i thërret Drejtori i Fondit. Në seancat e kolegjiutit profesional marrin pjesë: Drejtori i Fondit, Drejtorët e sektorëve, ndërsa sipas nevojës, edhe nëpunësit e tjerë profesionalë të Fondit.

V. SHËRBIMI PROFESIONAL I FONDIT

Neni 25

Për kryerjen e punëve profesionale, administrative dhe punëve të tjera për zbatimin e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor, në Fond është themeluar shërbimi i vetëm profesional.

Shërbimi profesional organizohet asisoj për të siguruar zbatim të ligjshëm, profesional, të përgjegjshëm, efikas, në kohë, ekonomik dhe racional të sigurimit të detyrueshëm shëndetësor.

Shërbimi profesional i Fondit organizohet në shërbim qendror me seli në Shkup, si dhe në shërbime rajonale që organizohen për rajonin e një apo më shumë komunave.

Rajonet që do t'i mbulojnë shërbimet rajonale të Fondit caktohen me aktin e përgjithshëm për organizimin e punës së Fondit.

Fushëveprimi dhe organizimi i punës së shërbimit qendror në Shkup dhe i shërbimeve rajonale më të afërta përcaktohen me akt të përgjithshëm të Fondit.

VI. PUNA PUBLIKE E FONDIT DHE E ORGANEVE TË TIJ

Neni 26

- Puna e Fondit është publike.
- Puna publike në Fond sigurohet me:

- dorëzimin e informacioneve për punën e Këshillit Drejtues të Fondit mjeteve të informimit publik;
- publikimin e statutit dhe të akteve të përgjithshme të parashikuara me Ligjin e Sigurimit Shëndetësor në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- dorëzimin e analizave për punën ekonomiko-financiare të Fondit dhe të Institucioneve të shëndetit publik Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Financave, Qeverisë dhe Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- njoftimin nëpërmjet mjeteve të informimit publik për punën e Fondit, në lidhje me realizimin dhe zbatimin e sigurimit shëndetësor të detyrueshëm;
- publikimin e një buletini informativ;
- mbajtjen e konferencave për shtyp;
- publikimin e informacioneve në ueb faqen e Fondit.

Të dhëna për publikun në lidhje me punën e Fondit mund të jep Drejtori i Këshillit Drejtues dhe Drejtori i Fondit, ose, me autorizim të tyre, edhe zëdhënësi (personi përgjegjës për kontakte me publikun) ose ndonjë i punësuar tjetër.

Si informacione të klasifikuara konsiderohen informacionet me interes për mbrojtjen si dhe informacionet, fshehtësia e të cilave garantohet me ligj.

Me një akt të veçantë të Fondit përcaktohen informacionet të cilat konsiderohen të klasifikuara dhe mënyra e të vepruarit me ta, në përputhje me Ligjin për informacionet e klasifikuara.

VII. MBROJTJA

Neni 27

Në gjendje lufte, Fondi zbaton masa dhe aktivitete për realizimin e veprimtarisë, në përputhje me Ligjin e Mbrojtjes dhe me aktet e tjera nënligjore nga fusha e mbrojtjes, ndërsa në mënyrë të veçantë, merr masa për mbrojtjen dhe shpëtimin e të punësuarve, të mjeteve të punës, të dokumentacionit dhe të materialit arkivor.

Për arsye të mbrojtjes së fshehtësisë së të dhënave dhe të informacioneve nga fusha e mbrojtjes, Fondi zbaton masa të veçanta për mbrojtjen e të njëjtëve.

VIII. MIRATIMI I AKTEVE TË PËRGJITHSHME

Neni 28

Statuti dhe aktet e përgjithshme me të cilat më afër rregullohen të drejtat dhe detyrimet nga sigurimi shëndetësor i detyrueshëm si dhe aktet e tjera të përgjithshme të Fondit, përgatiten në formë të propozimit.

Propozimi i statutit dhe propozimi i akteve të përgjithshme caktohen në seancë të Kolegjiut Profesional të Fondit, ndërsa miratohen në seancën e Këshillit Drejtues.

Neni 29

Pas miratimit, statuti dhe aktet e përgjithshme, për të cilat me Ligji nevojitet pëlqim, i dorëzohen organit kompetent për të marrë pëlqim.

Pas marrjes së pëlqimit nga paragrafi 1 i këtij neni, statuti dhe aktet e përgjithshme

publikohen në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Neni 30

Ndryshimi dhe plotësimi i statutit dhe i akteve të përgjithshme bëhet me të njëjtën procedurë siç edhe miratohen.

IX. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 31

(Neni 31 i Statutit të Fondit të Sigurimit Shëndetësor të Maqedonisë të publikuar në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” Nr. 27/12)

Ky statut hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” dhe do të botohet pas marrjes së pëlqimit nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Ditën e hyrjes në fuqi të këtij statuti, pushon të vlejë Statuti i Fondit të Sigurim Shëndetësor të Maqedonisë të botuar në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” Nr. 85 të vitit 2007 dhe 158 të vitit 2010.

Neni 32

(neni 2 i Vendimit ligjor për plotësimin e statutit të Fondit të Sigurimit Shëndetësor të Maqedonisë të botuar në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” nr. 64/15)

Ky Vendim statutor hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” dhe do të botohet pas marrjes së pëlqimit nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Neni 33

(neni 8 i Vendimit statutor për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Fondit të Sigurimit Shëndetësor të Maqedonisë të botuar në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” nr. 178/19)

Ky Vendim statutor hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë Veriore” dhe do të botohet pas marrjes së pëlqimit nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Numër: 02- _____

Drejtues

_____2019

Shkup

Управен одбор/Кëshilli

Претседател/Кryetari

Dr. Ridvan Asani